

PANDORA DEDJA

PROBLEME TË GJUHËS DHE TË STILIT TË LETËRSISË PËR FËMIJË

Gjuha dhe stili i letërsisë sonë për fëmijë në këto tridhjetë vjet të ndërtimit socialist të vendit kanë ecur përpara drejt përsosjes së tyre dhe përvetësimit të normave të njësuarra të gjuhës letrare. Ky zhvillim ka ecur krahas me rritjen e nivelit artistik të veprave për fëmijë. Pra, nuk është vështirë të konstatohet lidhja dhe vartësia reciproke midis përsosjes së gjuhës e stilit dhe cilësisë artistike në këtë letërsi. Mendoj se edhe kjo arritje në letërsinë për fëmijë duhet quajtur sukses i kulturës sonë kombëtare, pasi gjuha e veprave letrare për fëmijë është gjuhë që bëhet pronë e fëmijëve që në moshë të njomë, ndërsa fëmijët janë qytetarët e ardhshëm që do t'i mbajnë gjallë dhe do t'i zhvillojnë më tej normat e njësuarra të gjuhës letrare. Kështu duhet kuptuar roli shumë i madh edukativ dhe shoqëror i gjuhës dhe i stilit në veprat letrare për të vegjël.

Si ka ecur ky proces gjatë këtyre tri dekadave? Në mënyrë të përmbledhur mund të thuhet se letërsia jonë për fëmijë në vitet e para të Çlirimit nisi të lavrohej si një letërsi me një gjuhë krejt dialektore, që sillte me vete edhe veçoritë e stilit të të folmeve dialektore si dhe trajtat shumë të theksuara gramatikore e sintaktike të tyre. Në gjuhën e veprave të para për fëmijë, sipas origjinës krahinore të shkrimtarit, ndihej shumë ndikimi i të folmes tiranase, gjirokastrite, shkodrane etj. Po të studjohen me vëmendje veprat e para për fëmijë, nuk është vështirë të vihen re se pesha e këtyre ndikimeve ka qenë shumë e ndjeshme.

Ky proces ka vazhduar gati-gati, sipas vëzhgimeve tona, për dy dekada, gjer në fillim të viteve 60-të.

Konservatorizmi gjuhësor, trajtat e gabuara drejtshkimore, arkaizmat e barbarizmat në vepra të veçanta për fëmijë ishin atëhere diçka e rëndomtë. Shpesh deformimet e fjalëve u nënshtroheshin rregullave formale të stilistikës poetike si p.sh.: «Nalt e poshtë me kujdes, gjimnastikën baj çdo mjes» (A. Gj. Citimet janë nga libra për të vegjël, të cilëve u përmendim këtu vetëm inicialet e autorëve). «Pranvera erdh të nâ» (A. Gj.). Trajtat leksikore dialektore, arkaizma etj. shpesh i bënë veprat letrare të vështira për t'u lexuar nga fëmijët, sepse në to përdroreshin me bollëk fjalë të tilla si p.sh. «zgajtë», «moji» «rranza», «hukubet», «xhedertore», «derman», «ibret», «drangue», «lodja e synit» etj. Për këto fjalë nuk jepehin zakonisht as shpjegime gjuhësore dhe nuk merrej parasysh se libri

për fëmijë, për arsye të veçorive të moshës duhet të kishte një gjuhë më fjalor fjalësh sa më aktive dhe të përdorshme në të folur.

Përdorimi i apostrofit bëhej në mënyrë të tepruar, sa qëllonte që brenda një vargu për fëmijë të përdreshin gjer katër apostrofa, si p.sh. «Unë s'due t'ia dij je n'shkollë a n'lojë (K. J.) etj.

Të folurit e figurshëm jo rrallë nuk i përshtatej moshës, sepse mbështetej në krahasime abstrakte ose arkaike, siç vihet re në dy shëmbujt e mëposhtëm: kështu për të treguar dashurinë e fëmijëve ndaj mësueses autori përdorte në gjuhë figura e krahasime të tilla standarte «na don ta sytë, posi një nanë e dytë në mend të kemi gjithmonë, bashkë me lule si dhuratë merr edhe zemrën tonë», ose për të treguar heroizmin dhe sakrificat e partizanit trim, që bie në betejë, shkrimtari përdor vargje të tilla si p.sh. «Nuk kam vdekë, as jam plague, porse u lodha tue luftue nën një lis rash me pushue» (K. J.) etj.

Të gjitha këto, si dhe të meta të tjera të kësaj natyre, tani janë një fazë pak a shumë e kapërcyer e gjuhës së letërsisë sonë për fëmijë. Çfarë ndikoi për ta kapërcyer këtë gjendje?

Kjo lidhet me atë veçori specifike që ka letërsia për fëmijë për të qenë domosdo e lidhur ngushtë me shkollën, me mësimin dhe edukimin shkollor dhe veçanërisht me mësimin e gjuhës, të këndimit dhe të leximit letrar.

Kërkesat e programeve shkollore të gjuhës për të zbatuar normat e njësura drejtshkrimore ndikuan edhe në gjuhën e letërsisë për fëmijë, ndikuan për të zbutur kontradiktën midis gjuhës së librave letrare dhe gjuhës së teksteve dhe të mësimin në shkollë. Sipas mendimit tim ky proces ka ecur shpejt veçanërisht këto dhjetë vjetët e fundit.

Gjuha e librave për të vegjël ka marrë tani konturet e gjuhës së formuar e të njësuar letrare, duke zhvilluar më tej karakteristikat e saj specifike, si gjuhë e letërsisë për fëmijë dhe konkretisht me fjali të shkurtër, konstrukte të thjeshta dhe të drejta gramatikore-sintaktike, fjalor aktiv më të përdorshëm nga ana e fëmijëve, gjuhë të figurshme në përputhje me aftësitë kuptimore të tyre etj. Siç u prek edhe më lart, e gjithë kjo ka ndikuar për mirë për mësimin e gjuhës në shkollë, pasi tani me tekstet e reja është forcuar fronti unik i letërsisë për fëmijë dhe i lëndës së gjuhës dhe të leximit letrar në shkollë. Në librat e këndimit të ciklit të ulët të shkollës 8-vjeçare, ku më parë përfaqësohej shumë pak letërsia për fëmijë, tani thuhet 60-80 për qind e copave është marrë nga krijimet më të mira të shkrimtarëve tanë të sotëm për të vegjël. E njëjta gjë duhet thënë edhe për tekstet e gjuhës të ciklit të ulët, të cilat kanë bërë një hap përpara duke marrë copëza për ushtrime gjuhësore nga librat për fëmijë.

Ne na duket se këtej del edhe përfundimi i parë : **përdorimi i veprave të letërsisë për fëmijë në stil të gjerë në librat e këndimit, të leximit letrar dhe të gjuhës shqipe është një nga kushtet për të rritur ndikimin e saj në formë të organizuar për formimin e të folurit letrar dhe të shprehive drejtshkrimore të nxënësve.** Në gjykimin e përgjithshëm të këtij problemi duhet të marrim parasysh edhe ato të dhëna, që dalin nga vëzhgimet dhe konsultimet me mësues të ciklit të ulët të shkollës 8-vjeçare. Këta mësues pohojnë se thuhet të gjithë nxënësit e tyre që kanë nota nënta dhe dhjeta në gjuhën shqipe, pa përjashtim, janë lexues të

pasionuar të letërsisë për fëmijë. Po këta janë nxënësit që në shkrim nuk bëjnë gabime drejtshkrimore ose bëjnë shumë pak, që shprehen bukur dhe drejt në të folurit me gojë e që kanë fjalor shumë të pasur në krahasim me moshën e tyre.

Këtej nxjerrim edhe përfundimin e dytë, i cili ka rëndësi pedagogjike dhe metodike për shkollën tonë: *problemi i formimit të të folurit letrar dhe i shprehive drejtshkrimore të nxënësve është një front i gjerë, i cili nuk kufizohet as me orët e gjuhës e të këndimit dhe as me muret e klasës. Ky problem lidhet ngushtë edhe me metodikën e udhëheqjen e leximeve të lira të fëmijëve, me gjuhën që përdoret në familje, në ambientin dhe lodrat fëmimore etj. Ky problem lidhet ngushtë edhe me çështjen e fundit që do të shtrojmë, me përsosjen e mëtejshme dhe të vazhdueshme në këtë prizëm të gjuhës së letërsisë për fëmijë.*

*
* *
*

Vëzhgimet dhe konsultat me mësues na kanë dhënë mundësi për të përcaktuar konkretisht në vija të përgjithshme drejtimet kryesore të përsosjes së gjuhës së letërsisë për fëmijë, gjithnjë duke u nisur nga qëllimi për ta bërë këtë të fundit një mjet sa më efikas për formimin e shprehive drejtshkrimore dhe veçanërisht, të të folurit letrar të nxënësve.

Këto drejtime, siç tregon praktika e punës mësimore-edukative dhe përvoja e leximeve jashtëshkollore, janë tre:

Së pari, është e nevojshme të përsoset edhe më gjuha e figurshme e librave letrarë për fëmijë. Kjo gjuhë e figurshme duhet medoemos të ndërtohet në përputhje me aftësitë kuptimore të moshës; figurat, metaforat, krahasimet etj. duhet të marrin parasysh pasurinë e përvojës jetike të fëmijëve, pasi ndryshe ato mund të mos ndikojnë jo vetëm në botën emocionale, po as në zhvillimin intelektual të lexuesve të vegjël. Në këtë aspekt edhe në botimet e viteve të fundit vihen re mjaft lëkundje dhe dobësi, të cilat flasin për një transplatim mekanik të gjuhës së figurshme të letërsisë për të rritur në letërsinë për fëmijë, bile çfarë është dhe më shqetësuese edhe në letërsinë për moshën më të vogël të parashkolloreve. Shembujt e mëposhtëm mund të shërbejnë për të na krijuar bindje. P.sh. në një përrallë për fëmijë mbi lulen lexojmë radhë të tilla «Petalet e saj (të lules) ishin të mëdha dhe ngjyra-ngjyra. Ashtu të çelura drejt diellit, ato krijonin një kurorë të bukur, në mesin e së cilës dalloheshin disa fije në ngjyrë të verdhë. Ishin stamet e mbuluara plot me polen. Në fund të qelqores gjendej nektari i këndshëm». Dhe më poshtë, po aty: «Lulja tani është e lumtur. Petalet e saj u hapën përsëri drejt diellit, era e saj e ëmbël filloi të kundërmonte gjer larg. Në qelqoret poshtë stamave filloi të vërshojë nektari i ëmbël» etj. (Ç.R.)

Kur kujton gjuhën aq të thjeshtë e lakonike të përrallës popullore, të krijohet përshtypja se në shembullin e mësipërm ke të bësh me literaturë bujqësore dhe terminologji të saktë shkencore. Ka, gjithashtu, raste kur gjuha e figurshme është krejt abstrakte dhe në kundërshtim me karakterin konkret të të menduarit të fëmijëve si p.sh. në vargjet e mëposhtme:

*«Po ndezim ne traktorët
dhe vihemi në garë
me ta mbas disa vjetësh
do derdhemi në arë» (Ll. N.)*

Mënyra e tillë e të shkruarit nuk ndikon mirë në moshat e vogla për të krijuar koncepte të qarta mbi përdorimin e mjeteve gjuhësore si dhe për formimin e shprehisë së të folurit origjinal letrar. Në këtë formë zbehet dhe roli edukues i gjuhës së veprave letrare për fëmijë. Leon Tolstoi me të drejtë, duke pasur parasysh gjuhën e librave për fëmijë ka thënë: *«Puna për gjuhën është e tmerrshme, pasi këtu duhet që çdo gjë të jetë e bukur, e shkurtër, e thjeshtë dhe kryesorja e qartë»* . . . *«Unë i kam ndryshuar mënyrat e mia të shkrimit dhe të gjuhës. . . Gjuha që flet populli dhe e cila i ka gjithë tingujt për të shprehur gjithçka që mund të thotë poeti, për mua është shumë e shtrenjtë. Kjo gjuhë, veç të tjerash . . . është rregullatori më i mirë poetik. Provo të thuash ndonjë gjë të tepërt, të pispillosur ose të sëmurë, po gjuha e popullit nuk të lejon . . . për këtë arsye dashuroj çmendurisht çdo gjë rigoroze të qartë, të bukur dhe të ekuilibruar që gjej në poezinë popullore, në gjuhën dhe jetën e popullit»*.

Së dyti, përsosja e gjuhës së librave për të vegjël lidhet dhe me mundenësinë ose pamundenësinë e përdorimit të shprehjeve dialektore në gojën e personazheve. Ky është një problem vërtet delikat gjuhësor dhe letrar. P. sh. nuk është vështirë të vihet re që në prozën e gjatë për fëmijë, në romane e novela përdoren rëndom trajtat dhe shprehjet dialektore në gojën e personazheve. Ndoshta në letërsinë për pionierë një element i tillë mund të lejohej në rast se ruhet masa dhe kur është fjala për personazhe të moshës së kaluar, të cilët individualizohen edhe nëpërmjet koloritit gjuhësor të krahinës së tyre. Por, duhet t'i përmbahemi këtij kriteri, kur kemi të bëjmë me personazhe fëmijë të prozës së gjatë? Kjo duhet diskutuar, po të marrim parasysh se kjo letërsi ka të bëjë me lexuesit e vegjël dhe si e tillë, ajo luan një rol të fuqishëm në formimin e shprehive drejtshkrimore dhe të të folurit letrar të tyre. Ndërsa lidhur me letërsinë për moshat e vogla, për parashkollorët dhe shkollarët e vegjël, mendojmë se trajtat dhe shprehjet dialektore nuk duhen përdorur me teprim as në gojën e personazheve. Kjo kërkesë ka të bëjë me faktin se të folurit e fëmijëve të vegjël është në formim e sipër dhe se trajtat e gabuara të përvetësuara në këtë moshë ka rrezik të ruhen për një kohë shumë të gjatë.

Mendimi ynë është se vepra letrare për fëmijët e moshave të vogla duhet të jetë model i vërtetë i gjuhës letrare shqipe dhe i drejtshkrimit në të gjithë komponentët e saj, pasi pikërisht në këto mosha hidhen themelet e shprehive drejtshkrimore dhe të të folurit letrar.

Së treti, duhet të luftohet tendenca e thjeshtëzimit të gjuhës së veprave për fëmijë. Ka raste që disa autorë, duke u nisur nga qëllimi i mirë për të shkruar krijime të thjeshta, bien në gabimin tjetër të thjeshtëzimit të gjuhës, në paraqitjen e saj të thatë, të zbetë e pa jetë. Dëshira për të qenë korrekt me konstruktet gjuhësore i çon disa në një gjuhë të përdhunët, ose gjuhë fare pa kolorit që nuk ngjall asnjë emocion si p.sh. :

*«Nëpër male e pyje, lëndinash mbi bar,
shtylla kryelarta të gjithë kemi parë.
Ato shkëmbejnë fjalë ndër tela çeliku
se ç't'ardhme do sjellë tek ne elektriku.
Sa të bukura janë, e kush nuk i don,
dritëzat e bardha në llambat neon!» (N. S.)*

*
* *

Përgjegjësia e shkrimtarëve për fëmijë në edukimin gjuhësor të nxënësve dhe në veçanti, për formimin e shprehive drejtshkrimore dhe të folurit është shumë e madhe dhe me rëndësi në fazën konkrete që po kalon gjuha jonë e mrekullueshme. Kjo përgjegjësi nuk është thjesht estetike. Bile mund të themi se është një përgjegjësi arsimore dhe edukative në kuptimin e plotë të fjalës. Për nga pesha e vet e ndikimit, çdo vepër letrare për fëmijë është ekuivalente me çdo tekst shkollor të gjuhës apo të këndimit.

AUTORËT DHE VEPRAT E CITUARA

1. Arif Gjyli «Majtas, djathtas një-dy-tre»
2. Kolë Jakova «Kopshti i lulzuem», «Bri arta».
3. Çezar Ruhi «Dy arushë dhe pelikani»
4. Iliko Nano «Vala kaltëroshe».
5. Nikolla Spathari «Një shtyllë elektrike».

Résumé

QUESTIONS DE LANGUE ET DE STYLE DE LA LITTÉRATURE POUR ENFANTS

La langue et le style de notre littérature pour enfants, durant ce trentenaire de l'édification socialiste de l'Albanie, ont réalisé des pas méritoires vers leur perfection et l'assimilation des normes unifiées de la langue littéraire

Dans les années d'avant-la-libération du pays, notre littérature pour enfants prit le chemin d'une langue nettement dialectale. Le conservatisme linguistique, les erreurs d'orthographe, les archaïsmes dans des productions particulières pour enfants représentaient à cette époque ce qu'il y avait de plus commun. Le parler figuré n'allait point, souvent même, à l'âge auquel on s'adressait, appuyé qu'il était sur des comparaisons abstraites ou bien archaïques.

Désormais, cette phase de la langue de la littérature pour enfants est plus ou moins surmontée: Les exigences des programmes scolaires de la langue à appliquer les normes orthographiques unifiées influent, naturellement, aussi sur la langue de la littérature pour enfants; ces exigences influent aussi à atténuer la contradiction entre la langue des productions littéraires et celles des manuels scolaires. Les livres de lecture des classes inférieures de l'école de huit ans choisissent, à l'heure que nous sommes, les 60-80 pourcent de leurs pièces parmi les meilleures productions pour enfants de nos hommes de lettres.

Cet emploi de morceaux choisis littéraires à destination des enfants dans les livres de lecture et les manuels de langue albanaise représente une des conditions essentielles à accroître son influence systématique sur la forme du parler littéraire et des expressions orthographiques des élèves.

Les principales directions de la perfection de la langue de la littérature pour enfants, comme le montre d'ailleurs l'expérience du travail didactique d'éducation et celle des lectures extra-scolaires, sont ramenés par l'auteur Dedja à trois:

1° Il est nécessaire de perfectionner aussi la langue figurée des productions littéraires pour enfants. Cette langue doit être agencée en rapport avec les aptitudes cognitives de l'âge.

2° La perfection de la langue des productions pour enfants est aussi rapportée à la possibilité ou l'impossibilité d'usage d'expressions dialectales mises sur les lèvres des personnages.

3° On doit combattre la tendance de simplification de la langue dans les productions destinées aux enfants.

La responsabilité des écrivains pour enfants à inculquer le goût de la langue chez les élèves est des plus grands. Comme mesure d'influence, toute production littéraire pour enfants vaut autant que tout autre manuel scolaire de langue ou de lecture.